



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË
OSNOVNI SUD MITROVICI - BASIC COURT OF MITROVICA

P.nr.111/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti për Krime të Rënda, kryetari i trupit gjykues Bekim Veliqi, me procesmbajtësen Valdete Sadiku, në çështjen penale kundër të pandehurit A.B, për shkak të veprës penale Përvetësimi në detyrë nga neni 425 par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.49/2016, e dt:29.10.2018, e përfaqësuar nga Prokurori i Shtetit Fetije Bajrami - Shala, , pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar në bazë të nenit 359, 360, 361, 362, 366 të KPP-së me dt.05.11.2019 është marrë dhe shpallur publikisht aktgjykimi, ndërsa aktgjykimi është përpiluar me dt.08.11.2019;

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A.B, nga i ati T., e ëma I., e gjinisë T., i lindur me dt.... në ... ku edhe jeton në rr.“...” p.nr., me numër personal ..., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, i pa punë, i martuar, prind i 5 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike:

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:

Prej dt.13.11.2015 e gjerë me dt.01.02.2016 në ..., Ndërmarrja Publike Qendrore- Posta e Kosovës sh.a, në vendin e punës – të pozitës “...” në Zyrën Postare – ..., në cilësinë e personit zyrtar, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ka përvetësuar pasurinë e cila i është besuar për shkak të detyrës zyrtare, ashtu që i pandehuri me veprimet e anulimit të 14 pagesave të shërbimeve financiare jo bankare, e që gjatë kontrollit të bërë me dt.11.02.2016 nga Grupi punues dhe atë nga Auditori i brendshëm, Inspektorati postar, Departamenti i shërbimeve financiare jo bankare dhe Departamenti i sistemit të automatizimit të sporteleve është vërtetuar se i pandehuri me veprimet e anulimit të pagesave të shërbimeve financiare jo bankare ka përvetësuar për vete shumën prej 1.270,68€ (Euro).

Me këtë ka kryer veprën penale Përvetësimi në detyrë nga neni 425 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 41, 45, 46, 73 të KPRK-së dhe nenet 359, 360, 361, 365, 366 të KPP-së i;

S H Q I P T O N

I. DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej **gjashtë (6) muajve**, të cilin dënim do ta vuaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej **500€ (pesëqind euro)** të cilin dënim do ta paguaj në afat prej një (1) muaji nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në baë të nenit 46 të KPRK-së në zëvendësimin e dënimit me gjobë në dënim me burgim duke llogaritur 20€ (njëzet euro) për një ditë të kaluar në burg.

II. Obligohet i akuzuari që të dëmtuarës Ndërmarrjes Publike Qendrore – Posta e Kosovës sh.a në Prishtinë, ti kompensojë dëmin material në shumën prej 1.270,68€ (njëmijë e dyqind e shtatëdhjetë euro e gjashtëdhjetë e tetë cent) të gjitha këto në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm.

III. Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurale dhe atë në shumën prej 50€ (pesëdhjetë euro) ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20€ (njëzet euro) si dhe 50€ (pesëdhjetë euro) në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

IV. Kryetari i trupit gjykues pas shpalljes së aktgjykimit dhe pëlqimit të të akuzuarit, duke vendosur sipas nenit 47 të KPRK-së, e zëvendëson dënimin e lartshënuar me ***burg në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh në DËNIM ME GJOBË në shumë prej 2000€ (dymijë euro)***, ashtu që i akuzuari është i obliguar që shumën e caktuar ta paguaj në afat prej 2 (dy) muajve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast të mos pagesës së dënimit me gjobë do të veprohet në kuptim të nenit 46 të KPRK-es.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP.I.nr.49/2016, e datës 29.10.2018, ndaj të pandehurit A.B nga ... për shkak të veprës penale Përvetësimi në detyrë nga neni 425 par.1 të KPRK-së.

Kryetari i trupit gjykues ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar, gjatë seancës së shqyrtimit fillestar, ka prezantuar Prokurori i Shtetit Fetije Bajrami - Shala, i pandehuri A.B dhe është vazhduar me mbajtjen e seancës së shqyrtimit fillestar.

Gjatë kësaj seance të shqyrtimit fillestar i pandehuri është udhëzuar dhe njoftuar me të drejtat e tij komform nenit 246 par.1 të KPP-së, pas deklarimeve të të pandehurit është vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, i pandehuri është deklaruar se e kupton aktakuzën dhe pas bindjes së gjyqtarit se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, i është ofruar mundësia që të pranojë fajësinë apo të deklarohet i pafajshëm, i pandehuri është deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë sipas aktakuzës.

Gjykata e ka njoftuar të pandehurin për pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale Përvetësimi në detyrë nga neni 425 par.1 të KPRK-së, respektivisht dënimi që parashihet për këtë veprë penale, po ashtu duke e njoftuar të pandehurin se sipas nenit 383 par.2 të KPP-së në rast të pranimit të fajësisë nga i pandehuri i njëjti nuk e ka të drejtën e ushtrimit të ankesës për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, provat nuk do të administrohen gjatë kësaj seance, por ato do të vlerësohen me rastin e matjes së dënimit, po ashtu pranimin e fajësisë gjykata do ta vlerësojë si rrethanë lehtësuese në rastin e caktimit të dënimit.

I pandehuri ka deklaruar se i kupton pasojat e pranimit të fajësisë dhe rrethanat lehtësuese që i merr gjykata me rastin e matjes së dënimit dhe i pandehuri qëndron pranë pranimit të fajësisë.

Në mbështetje të nenit 248 par.2 të KPP-së, është kërkuar mendimi i Prokurorit të Shtetit lidhur me deklarimin e të pandehurit për pranimin e fajësisë, e cili ka deklaruar që gjykatë të pranojë pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, pa imponime, i mbështetur në provat materiale mbi bazat e së cilës është

ngritur edhe kjo aktakuzë, gjykata të merr të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese të parapara me ligj, gjykata të vlerësojë korrektësinë e të pandehurit në çdo fazë të procedurës penale.

Pas kësaj kryetari i trupit gjykues është i bindur se i pandehuri e kupton natyrën e pranimit dhe pasojat e pranimit të fajësisë, dhe në procesverbal te seance në kuptim te nenit 248 par.4 e lidhur me par.1 nenpar.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 të KPP-së, është marrë aktvendim duke pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pasi që i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit, pranimi është bërë në mënyrë të vullnetshme dhe se pranimi i fajësisë mbështet në provat materiale dhe se aktakuza nuk përmban shkelje ligjore ose gabime faktike.

I pandehuri pas pranimit të fajësisë nga ana e Gjykatës ka shtuar se i vjen keq për veprimin, është i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, prind i 5 fëmijëve, ka kërkuar nga gjykata që ti caktohet një dënim sa më të lehtë.

Prokurori i shtetit ka theksuar qe gjykata me rastin e matjes se dënimit te marre për baze te gjitha rrethanat renduese dhe lehtësuese te parapara me ligj, gjykata te vlerësoj korrektësinë e te pandehurit ne çdo faze te procedurës, po ashtu te e vlerësoj pranimin e fajësisë.

Pasi që Gjykata ka pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe me që nga palët nuk ka pasur propozime të reja për plotësimin e procedurës, kryetari i trupit gjykues e ka shpallur përfundimin e këtij shqyrtimi dhe i ka njoftuar palët se Gjykata ka vazhduar në mbështetje të nenit 248 par.4 të KPP-së, me shqiptimin e dënimit - respektivisht me shpalljen publike të aktgjykimit, e cila shpallja e aktgjykimit është bërë po të njëjtën ditë, shpallja ka qenë e hapur dhe publike, në prezencë të të pandehurit dhe në mungesë të Prokurorit të Shtetit, ku kryetari i trupit gjykues pas publikimit të aktgjykimit dhe pëlqimit të të pandehurit duke vendosur *sipas nenit 47 të KPRK-së e zëvendëson dënimin e lartshënuar me burg në kohëzgjatje prej gjashte (6) muajsh në DËNIM ME GJOBË ne shumë prej 2000€ (dymijë euro), siç konstatohet ne dispozitiv te aktgjykimit.*

Në lidhshmëri të pranimit të fajësisë nga i pandehuri në vlerësimin dhe analizimin e provave materiale dhe atyre personale që janë pjesë përbërëse e kësaj çështje penale dhe në mbështetje të nenit 361 të KPP-së, gjykata vërtetoi se ekzistojnë prova se në veprimet e të pandehurit jane konsumuar elementet e veprës penale me te cilën akuzohet, kjo konstatohet nga Raproti i verifikimit të anulimeve të shërbimeve financiare jo – bankare Regjioni ... dhe konstatimi i keqpërdorimeve nga ana e sportelistit A.B i dt.16.02.2016, kërkesat nga Zyra postare për anulim të pagesave si dhe fletëtransferet e gjeneruara nga SASP për rastet e keqpërdorimit, Procesverbali mbi gjendjen e arkës – Sportelit i dt.18.09.2014, Vendimin e Komisionit Disiplinor nr.... i dt.28.10.2014, Raporti për paraqitje në Komision Disiplinor Nr.... i dt.07.07.2014, Vendimin e Komisionit Disiplinor Nr.... i dt.20.08.2014, Vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës Nr.... i dt.16.02.2016, Raporti për paraqitje në Komisionin Disiplinor Nr.... i dt.25.09.2014, deklarata e të pandehurit e dhënë në Prokurori e dt.29.10.2018, andaj të gjitha këto vërtetojnë rrethanat për gjendjen faktike të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe me këto veprime përmbushen – krijohen elementet e veprës penale Përvetësimi në detyrë nga neni 425 par.1 të KPRK-së të gjitha rrethanat si më lartë tregojnë gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e caktimit të llojit të dënimit dhe matjes së lartësisë së dënimit për të akuzuarin, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së, duke i shqiptuar dënim si në dispozitiv të aktgjykimit si rrethanë lehtësuese mori për bazë pranimin e fajësisë nga i pandehuri, nga te dhënat është hera e pare qe bie ndesh me ligjin, prind i 5 fëmijëve, mbajtës i familjes, deklarimin e Prokurorit te Shteti qe te vlerësohet korrektësinë e te pandehurit ne çdo

faze te procedurës penale, shprehjen e keqardhjes, gatishmërinë e tij që të kompensojë demin e shkaktuar palës së dëmtuar, ndërsa si rrethana rënduese që kanë të bëjnë me këtë çështje penale, mori shkallën e përgjegjësisë penale, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë, demin e shkaktuar ndaj palës së dëmtuar, gjykata në vlerësim të rrethanave të theksuara me lartë i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar me bindjen të plotë se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i këtij dënimi i paraparë sipas nenit 41 të KPRK-së, duke pasur efektin në parandalimin e kryeseve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit dhe nga të gjitha këto ka konsideruar se dënimi i shqiptuar është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale për të pandehurin.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendimin e mori në bazë të nenit 450 të KPP-së, në bazë të nenit 463 par.2 të KPP-së u vendos për kërkesën pasurore juridike, pasi që në dispozitiv të aktgjykimi është e përcaktuar saktë dëmi i shkaktuar palës së dëmtuar, fakt që nuk mohohet as nga i pandehuri dhe mos aprovimi do të parashihte shkelje esenciale të dispozitave procedurale nga neni 384 par.1 nën par.1.7 të KPP-së, siç e përcakton dispozita konkrete, ndërsa taksa për kompensimin e viktimave të krimit në kuptim të nenit 39 par.3 nën par.3.2 të Ligjit nr. 05\L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga të cekurat si më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti për Krime të Rënda
P.nr.111/2018 dt.08.11.2019

Procesmbajtësja
Valdete Sadiku

Kryetari i trupit gjykues
Bekim Veliqi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.